



KRYETARI I KOMUNËS  
MUNICIPAL PRESIDENT  
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

DATA/DATUM/DATE	22.10.2024
NR/BR.	325/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale 706-0, Z.K. Lloshkobare, pronë e komunës së Ferizajt, me pjesën e ngastrën kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare, pronë e private

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr.04/L-144 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15 qershor 2008), nenit 24 të Ligjit nr.06/L-092, për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të miratojë:

#### PROPOZIM VENDIMIN

Për;

1. Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale 706-0, Z.K., Lloshkobare me sip. 99 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur, pronë e komunës së Ferizajt, me;
  - Ngastrën kadastrale 705-3, Z.K., Lloshkobare, me sip. 82 m<sup>2</sup>, pronë e Fehmi (Isuf) Mehmeti dhe
  - Ngastrën kadastrale 705-4, Z.K., Lloshkobare, me sip. 17 m<sup>2</sup>, pronë e Fehmi (Isuf) Mehmeti.

2. Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë të regjistruara parcela 706-0, Z.K., Lloshkobare në pronësi të Komunës së Ferizajt dhe parcela kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare janë të regjistruara në emër të Fehmi (Isuf) Mehmeti. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.
3. Pronat e përshkruara më lartë këmbehen me qëllim të organizimit – rregullim të parcelave, paraprakisht këto prona janë shpallur interes i përgjithshëm nga Kuvendi Komunal sipas vendimit me nr. 01 Nr. 81 i datës 31.08.2023.
4. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

Të bashkangjitura në këtë propozim vendim i gjeni;

- *Vendimin e Kuvendit me nr. 01 Nr. 81 i datës 31.08.2023.*
- *Çertifikatat e pronësisë me kopje plani,*
- *Vërtetimin se prona private është në kufijt kadastral me pronën e komunës.*

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ			
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA			
Datede / Izlaze: Date / Dana: 05.08.2023			
Nr. Orgv. Org. jed.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqeve. Br. Strana.	
01	81	2	
Ferizaj - Uroševac			



REPUBLIKA E KOSOVËS



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.81  
Date: 31.08.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi pika 12.1 dhe 12.2, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24 par 4 I Ligjit nr 06/L-092 Për dhënie në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenin 51 pika 2.9 të statutit të Komunës Ferizajt 01.nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2023 miratoi këtë:

#### VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K.Lloshkobare, pronë private me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 706-0 Z.K.Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizaj.

#### I

Shpallen interes i përgjithshëm pjesët e ngastrave kadastrale:

- 705-3 Z.K.Lloshkobare me sipërfaqe 82m<sup>2</sup>, pronë private e Fehmi Mehmetit dhe
- 705-4 Z.K.Lloshkobare me sipërfaqe prej 17m<sup>2</sup>, pronë private e Fehmi Mehmetit me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 706-0 Z.K.Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizaj.

#### II

Qëllimi i shpalljes interes i përgjithshëm i pjesëve të ngastrave kadastrale të lartëcekur është rregullimi I parcelave.

#### III


Pronat e përshkruara me lartë shpallen interes i përgjithshëm duke u bazuar në kërkesën e palës e cila evidentohet me nr 10-463-147 e datës 05.09.2022.

#### IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastrit.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.






Komuna: FERIZAJ  
Zona Kadastrale : Lloshkobare  
Drejt për Pron. Gjeodezi dhe Kadaster  
-Sektor i Pronës

## SKICA E MATJES

Pa Përpjes



Ngjyra e verdhë tregon pjesën e ng. kad. 705-3 me sip. 82m<sup>2</sup> dhe 705-4 me sip. 17m<sup>2</sup> z.k. Lloshkobare pronë private me qëllim të këmbimit me pjesën e ng. kad. 706-0 me sip. 99m<sup>2</sup> pronë e komunës së Ferizajit-Rrugë  
Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm me qëllim të këmbimit.

Ferizaj: 18.10.2024

Punoi Gjeodeti: *Mehmet Mehmeti*





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme  
Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Ferizaj Zona Kadastrale: Lloshkobare

Të dhënat sipas Elaboratit/Certifikatës së Pronës		Vlerësimi DVPPSHK					
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m <sup>2</sup>	Sipërfaqja për vlerësim m <sup>2</sup>	Çmimi i tokës (€ /m <sup>2</sup> )	Totali (€)
1	FEHMI (ISUF) MEHMETI	705-3	Tokë Ndërtimore	493	82	27.00	2.214.00
2	FEHMI (ISUF) MEHMETI	705-4	Arë e klasës 4	2193	17	27.00	459.00

Approvi date:





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Ferizaj Zona Kadastrale: Lloshkobare

		Të dhënat sipas Elaboratit/Certifikates se Pronës			Vlerësimi DVPPSHK		
Nr.	Pronar/Posedues	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m <sup>2</sup>	Sipërfaqja për vlerësim m <sup>2</sup>	Çmimi i tokës (€ /m <sup>2</sup> )	Totali (€)
1	P.SH. RRUGË	706-0	Infrastrukturë	976	99	27.00	2,673.00

Approvatolet:





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*  
*Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and*  
*Transfers*

*Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme*

---

*Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department*

**RAPORT – VLERËSIMI**

*Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim*



## **H Y R J A**

Më datë 21.08.2024 në mbështetje të nenit 22, paragrafi 3 i ligjit Nr. 03/l-139, Datë 26.03.2009 “Për shpronësimin e pronës së paluajtshme”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, mori në shqyrtim kërkesën referencë 10-Nr 463-211 datë 05.08.2024 (Pranuar në MFPT 324/2024 prot, Datë 05.08.2024) që i përket subjektit:

**Komuna: Ferizaj**

**Me objekt kërkesë : Kërkesë për vlerësimin e pronave**

## PËRMBAJTJA

**Prona:** 706-0

**Pronar :** PSH. RRUGË

**Zona Kadastrale:** Lloshkobare

**Komuna:** Ferizaj

**Data e inspektimit :** 21.08.2024

**Data e Vlerësimit:** 26.09.2024

**Përgatiti raportin:** DIVIZIONI PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË  
PALUAJTSHME PËR SHPRONËSIM DHE KËMBIM

**Vlera e pronës së paluajtshme:** 2,673.00 EURO



## I. LIGJET E APLIKUESHME

Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë përmes ligjit.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/L-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", të ndryshuar, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ka kompetencën ekskluzive për vlerësimin e të gjitha pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i procedurës së shpronësimit dhe llogaritjen e dëmeve që kanë të bëjnë shpronësimin, nga cilido organ shpronësues.

Si dhe akti nënligjor i cili derivon nga Ligji Udhëzimin Administrativ nr 02/2015 të miratuar nga Ministria e Financave "Për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

Po ashtu me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes", Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Departamenti të Tatimit në Pronë i është shtuar edhe përgjegjësia e vlerësimit të pronave të paluajtshme nën administrimin e AKP-së dhe Komunave, të cilat propozohen të këmben midis tyre dhe Këmbimi i pronës komunale me persona fizik dhe juridik.

Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij raporti, termet dhe shprehjet, kurdo që përdoren në këtë raport, kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht kanë kuptim tjetër:

**"Pronë e Paluajtshme"** nënkupton

(i) tokën,

(ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuara në, mbi ose nënsipërfaqen e tokës si dhe

(iii) pjesët përbërëse dhe sendet aksesore të cilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe

(iv) frutat e pa shkëputura nga toka.“

**" Pronë e paluajtshme e Komunës"** – pronë e paluajtshme e regjistruar në emër të komunës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

**" Këmbimi"** - e drejta e Komunës për të bërë ndërrimin e pronës së paluajtshme të Komunës me personat fizik dhe juridik.

## II. TË DHËNAT MBI PRONËN SIPAS ÇERTIFIKATËS MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME:

<b>Pronari:</b>	PSH. RRUGË
<b>Adresa:</b>	
<b>Zona kadastrale:</b>	Lloshkobare
<b>Nr. i pronës:</b>	706-0
<b>Komuna:</b>	Ferizaj
<b>Kultura/ Klasa:</b>	Infrastruktura
<b>Sipërfaqja e përgjithshme:</b>	976 m <sup>2</sup>

## QËLLIMI I VLERËSIMIT

Shpronësim <input type="checkbox"/>	Këmbim <input checked="" type="checkbox"/>	Servitut <input type="checkbox"/>
-------------------------------------	--	-----------------------------------

## III. PËRSHKRIMI I ZONËS PËRRETH, PRONËS SË PALUAJTSHME DHE TË DREJTAVE QË PREKEN NGA PROCESI I KËMBIMIT

Ferizaji shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës. Paraqet një udhëkryq të rëndësishëm, sepse nëpër Ferizaj kalojnë të gjitha rrugët e rëndësishme që e përshkojnë Kosovën nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Këto rrugë pastaj vazhdojnë edhe në shtetet fqinje dhe në rajon. Komuna e Ferizajt ka 720 km katrorë, ka gjithsejtë 44 fshatra, në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune.

Qyteti i Ferizajt është një ndër qendrat më të reja të Kosovës, andaj ekonomia e këtij qyteti është zhvilluar në vitet e vonshme.

Një ndër faktorët më të rëndësishëm nga e kaluara historike për formimin e qytetit të Ferizajt dhe të zhvillimit ekonomik të tijë, është padyshim ndërtimi i vijës hekurudhore (1873) dhe stacionit hekurudhorë, linjë kjo shumë e rëndësishme për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, që njëkohësisht ndikoi shumë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimit shëndrruar atë në qytet.



Zanafilla e ekonomisë së qytetit fillon me disa veprimtari, kryesisht zejtare dhe tregtare kështu p.sh në vitin 1900, Ferizaji nga 400 shtëpi sa kishte në atë kohë, 200 prej tyre ishin dyqane. Përveç fabrikës së tjegullave, të gjitha ndërmarrjet tjera që ekzistojnë në Ferizaj, janë themeluar pas luftës së dytë botërore.

Zona Kadastrale Loshkobare në veri-perëndim të qytetit të Ferizajt, me një territor të gjerë me toka bujqësore dhe kodrinore. Zona Kadastrale LLozhkobare nga qendra e qytetit të Ferizajt ka një distancë rreth 3 km.

Zona Kadastrale LLozhkobare gjeografikisht kufizohet me disa zona, në veri kufizohet me Zonat Kadastrale Kosinë, në lindje me Zonën Kadastrale Mhoc, ndërsa në jug me Zonat Kadastrale Talinoc i Jerlive dhe Ferizaj si dhe në perëndim me Zonat Kadastrale Balaj, Nerodime e Epërme dhe Muhaxher .

Pjesa lindore e zonës karakterizohet me territore kryesisht të rrafshet me toka bujqësore dhe në disa pjesë janë të përqendruara vendbanimet me shtëpi dhe lagje individuale.

Ndërsa në pjesën perëndimore të zonës kemi një konfigurim tjetër karakterizohet me terren kodrinor dhe malorë. Këtë zonë e ndan në mes rruga regjionale Ferizaj- Shtime dhe shërben si arteria kryesore e dy qyteteve. Përgjatë dy anëve të rrugës janë përqendruar objekte të ndryshme afariste dhe biznesore e komerciale dhe pjesa dërmuese e banimit është e shtrire përgjatë këtij aksi rrugor.

Për Vlerësimin e pronës së paluajtshme, stafi i Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim, filluan punën për inspektimin e pronës, përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për të dhënat e tregut në zonën përreth pronës, e cila është objekt këmbimi.

Gjatë inspektimit u kryen verifikimet për pronën që do të vlerësohet, u përcaktua vendndodhja e pronës, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Vlerësimi i pronës është bërë në bazë të gjendjes faktike në ditën e inspektimit.

**\*Objekt vlerësimi në këtë raport është:**

- Sipërfaqja e tokës e cila vlerësohet sipas elaboratit

Pronën me numër 706-0 me kulturë "Infrastruktura" në Zonën Kadastrale LLozhkobare objekt vlerësim për këmbim shtrihet në lagje periferike, me konkretisht në afërsi të rrugëve " BesëLidhja Shqiptare", "Pavarësia " dhe "Sali Bajrushit".

Sipas elaboratit dhe gjendjes në terren në ditën e inspektimit prona kishte formë të çrregullt, ishte oborr në të cilën ndodhej e ndërtuar shtëpia për banim individual me planimetri moderne dhe infrastrukture përcjellëse. Objekt vlerësimi në këtë pronë është një pjesë e pronës e cila përdoret për oborr.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësim, sipas elaboratit nuk ka "Pjesë aksesori" pjesët aksesore nënkuptojnë ndërtim, instalime, te cilat janë vendosur apo montuar në pronën e paluajtshme , për përdorim të përhershëm dhe të cilat nuk mund të shkëputen pa përpjekje ta pa arsyeshme ose jo ekonomike.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësimi sipas elaboratit, nuk ka "Fruta"- që nënkupton frutat e pa shkëputura nga toka, bimësinë vjetore apo të përhershme , në një pronë të paluajtshme.

Prona objekt vlerësimi për këmbim vlerësohet sipas Vendimit 01.Nr.81 datë 310.8.2023.

#### **SIPËRFAQJA:**

Sipërfaqja e pronës:	976 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja që vlerësohet :	99 m <sup>2</sup>
<b>Prona u inspektua me datë :</b>	21.08.2024

#### **IV. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE**

##### **Metodat e vlerësimit:**

1	Metoda e kostos	
2	Metoda e shitjeve krahasuese	✓
3	Metoda e të ardhurave	

Metoda e shitjeve krahasuese është metoda më e preferueshme për vlerësimin e pronave të paluajtshme, nëse ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme, brenda një periudhe të caktuar kohe, për shitblerjet që kanë ndodhur në një rajon të caktuar si dhe të dhëna për studimin e tregut.

Përkufizimi i "vlerës së tregut" është:

*"Vlera e tregut të pronës së paluajtshme nënkupton shumën e përafërt të vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehet në datën e miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore ose në datën e paraqitjes fillestare të kërkesës, mes një shitësi dhe blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me*

*njëri tjetrin, dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim".*

### **Vlera e Tokës Tjetër**

1. Për përcaktimin e vlerës së tokës tjetër që nuk është tokë bujqësore, pyjore dhe ndërtimore, merren parasysh kriteret e mëposhtme:

1.1. Madhësia e parcelës në m<sup>2</sup>;

1.2. Shfrytëzimi i vazhdueshëm i parcelës.

2. Përveç kriterëve të mësipërme në përcaktimin e vlerës së tokës tjetër që nuk është tokë bujqësore, pyjore dhe ndërtimore, merren parasysh edhe kriteret e tjera si kushtet mjedisore dhe kushtet e terrenit, nëse këto të fundit kanë një ndikim të dallueshëm në vlerësimin e pronës së paluajtshme.

### **V. KONKLUZIONI**

Për përgatitjen e këtij raporti është bërë inspektimi i pronës por nuk është kryer një mbikqyrje strukturore, si dhe në mungesë të të dhënave në elaborat nuk jemi në gjendje të raportojmë nëse prona ka ose jo difekte strukturore.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MF - Nr. 02/2015 Për Miratimin e Metodave dhe Kriterëve Teknike të Vlerësimit për Përlllogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe Dëmeve që kanë të Bëjnë me Shpronësimin, vetëm në rastet kur në rajonin ku parashikohet të ndodhë shpronësimi për interes publik, mungojnë treguesit e shitblerjes, apo ka të dhëna të besueshme se këta tregues janë abusive dhe jo real, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim mund të marrë të dhëna të nevojshme shtesë nga subjektet e listuara në nenin 16, paragrafi 2 dhe 3 i këtij udhëzimi.



Opinioni për Vlerën e pronës së paluajtshme që është objekt i këtij vlerësimi, në përputhje me përkufizimet, analizat, dhe supozimet e më sipërme është:

NUMRI I PRONËS	SIPËRFAQJA QË VLERESOHET m <sup>2</sup>	ÇMIMI PËR €/m <sup>2</sup>	VLERA E PRONËS €
706-0	99 m <sup>2</sup>	27.00€	2,673.00€

Zyrtarët e DVPPSHK-së:

1.  Numri i licencës\_VP026

2.  Numri i licencës\_VP099

Udhëheqësi i DVPPSHK-së:

 Numri i licencës\_VP004

Drejtoreshë e DVPP-së







Aktit të vlerësimit i bashkangjiten dokumentat e mëposhtme:

1. Fotografitë e pronës së paluajtshme/zonës përreth
2. Dokumentacioni harto grafik, që përbëhet nga plani përkatës kadastral dhe harta e parcelës përkatëse;
3. Pjesa grafike e pronës dhe sipërfaqja që këmbëhet;
4. Dokumentat e pronësisë.

Përgatitur nga Eksperti i Gjeodezisë:

  
\_\_\_\_\_






NUMRI I PRONËS  
Zona Kadastrale :Lloshkobare  
Drejt.për Pron.Gjeodezi.dhe Kadaster  
-Sektori i Pronës

### SKICA E MATJES

Pa Përpjes



Ngjyra e verdhë tregon pjesën e ng.kad.705-3 me sip.82m² dhe 705-4 me sip.17m² z.k Lloshkobare pronë private me qëllim të këmbimit me pjesën e ng.kad. 706-0 me sip.99m² pronë e komunës së Ferizajt-Rrugë Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm me qëllim të këmbimit.

Ferizaj: 17.08.2023

Punoi Gjeodeti: *Alhmet Alhmeti*









Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

Zyrtare

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217056-00706-0

Numri i Hëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	63290/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	30.07.2024 - 09:33
Komuna / Opština / Municipality:	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Lloshkobare / Laskobare / Balçak
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Firshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217056-00706-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		976			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LAGJA E MESME				





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : FERIZAJ

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lloshkobare

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-72217056-00706-0	Parcelë / Parcela / Parcel	976



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1043